


Nr.regj:29061/2010



GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Gyltene Sylejmani, nga neni 14 par.3 e sanksionuar me nenin 16 par 1 pika 1.5 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te Larte Publikë, e në bazë të nenit 73, 74, dhe 199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, më datë 28.06.2011 merr këtë:

A K T V E N D I M

E PANDEHURA Gyltene Nevzat Sylejmani ,e lindur me 27.04.1956 ne Vushtrri,me vendbanim ne Prishtine rr."Ali Hadri" nr.9,e martuar nënë e tre femijeve,ka te kryer fakultetin ,gjiqtare,dhe jeton ne gjendje te dobet ekonomike.

E s h t e p e r g j e g j e s e

Sepse si zyrtare e larte,nuk e ka bere plotesimin, gjegjesisht permiresimin e formularit lidhur me deklarimin e pasurise ,prane Agjensionit Kunder Korrupsion ,ne afatin e caktuar ligjor.

Me veprim te ketille ka kryer kundervajtje nga neni 14.3 i sanksionuar me nenin 16 par.1 pika 1.5 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise te Zyrtareve te Larte Publikë, andaj per kete,

. G J O B I T E T

Me gjobë në shumën prej 150 (njqind e pesedhjetë) €, të cilën gjobë është e obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës kur ky aktvendim të merrë formë të prerë, në llogarine e te hyrave te KGJK-se, No.1000 4300 7000 0518.Pagesa behet ne ndonjeren agjensi per mbledhjen e te hyrave –banke,permes urdherpageses te plotesuar nga gjykata .Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 10 ditësh, duke llogaritur 15 (pesëmbëdhjetë) €, për një ditë burgimi.

Shpenzime te procedures nuk ka patur,kurse ne emer te paushallit gjyqesor i pandehuri eshte i obliguar te paguaje shumen prej 5(pese) €,ne sherbimin e arkes se gjykates.

Nga një kopje e këtij aktvendimi t'i dorzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

- ✓ **Agjensia Kunder Korrupsionit,Prishtine** parashtroi kërkesen me nr.01/3209/10 më dt. 24.09.2010 për fillimin e procedurës së kundërvajtjes kundër pandehurit te cekur më lartë dhe për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Ne baze te kerkeses se parashtruar u inicua procedura kundervajttese me marrjen ne pyetje te pandehuren ,e cila deklaroi se ,kerkesa e Agjensise Kunder Korrupsion nuk i eshte dorezuar personalisht, gjegjesisht kerkesa per plotesimin e formularit eshte pranuar nga ana e punetori teknik i Gjykates Supreme,dhe te njejtës i eshte dorezuar me date 17.09.2010 ndersa formularin per deklarimin e pasurise te plotesuar e ka derguar ne Agjension me date 01.10.2010.

Ne baze te te dhenave ne kerkeses,deklarates se te pandehures, shiqimit te shkresave te lendes dhe provave tjera te administruara gjate procedures, Gjykata konstatoi se e pandehura e ka kryer kundervajtjen e cila me kerkeses i vihet ne barre,per çka u shpall pergjegjese dhe u denua me gjobe si ne dispozitiv te ketij aktvendimi .

Me justin e shqiptarut të denimit konformisht 7 të Ligjit të mocimit parasjasi të gjithë rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes, dhe të pandehures iu shqiptua denimi me gjobe në lartësi si në dispozitiv, duke konsideruar se edhe me këtë do të arrihet efekti i sanksionimit, ashtu që e pandehura në të ardhmen të shmangët kryerjes së veprave të tilla apo të ngjashme kundërvajtëse.

Me sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të parashtrijë i pandehuri dhe parashtruesi i kërkesës, Gjykates së Lartë për Kundërvajtje, në afatin prej 8 ditësh, pas marrjes së këtij aktvendimi, nëpërmjet kësaj gjykate dhe pa taksë.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË

